

**UDHËZIM**  
**Nr. 17, datë 26.7.2016**

**MBI PROCEDURAT E PËRJASHTIMIT NGA DETYRIMET E IMPORTIT DHE  
DETYRIMET E TJERA TATIMORE TË LËNDËVE DJEGËSE PËR PËRDORIM PËR  
NEVOJA ZYRTARE DHE PERSONALE, NË KUADËR TË MISIONEVE DIPLOMATIKE  
DHE KONSULLORE, MISIONET SPECIALE TË AKREDITUARA NË SHQIPËRI, SI  
DHE TË ORGANIZMAVE NDËRKOMBËTARË, TË NJOHUR SI TË TILLË NGA  
REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, nenit 184, të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 10; shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 14, dhe nenit 108, të ligjit nr. 61/2012, datë 24.5.2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pikat 33 dhe 34, të nenit 56 dhe pika 1, paragrafët “a” dhe “b”, të nenit 60, të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 95 të vendimit nr. 919, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, nenit 18 dhe shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 38, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 612/2012, datë 5.9.2012, “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat””, të ndryshuar, ministri i Financave

**UDHËZON:**

**I. Përfashtimi dhe pajisja me autorizim**

1. Lëndët djegëse për përdorim për nevoja zyrtare dhe personale, në kuadër të misioneve diplomatike dhe konsullore, misioneve speciale të akredituara në Shqipëri, si dhe të organizmave ndërkombëtarë, të njohur si të tillë nga Republika e Shqipërisë, përfashtohen nga akciza, TVSH-ja apo edhe nga detyrimet e tjera sipas specifi-kimeve dhe limiteve të përcaktuara në konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga legjislacioni i brendshëm.

2. Subjektet përfituese të përfashtimit sipas pikës 1, aplikojnë për t’u pajisur me autorizim për përfashtim, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, sipas formularit të aplikimit në aneksin nr. 1 të këtij udhëzimi. Aplikimit i bashkëngjitet dokumentacioni i mëposhtëm:

a) Konfirmimi nga Ministria e Punëve të Jashtme me cilësinë e autoritetit përgjegjës, lidhur me sasinë, llojin dhe cilësinë e lëndëve djegëse dhe llojin e taksave që përfitohet përfashtimi për përdorim për nevoja zyrtare dhe personale nga trupi diplomatik.

b) Mënyra e furnizimit dhe sasinë respektive për çdo lloj lënde djegëse në:

i) import;

ii) blerjet me pakicë brenda vendit.

c) Kopja e kontratës së shitblerjes me kompaninë importuese apo shitëse në varësi të mënyrës së furnizimit

3. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave brenda 3 (tri) ditëve, miraton ose refuzon autorizimin për përfashtim nga detyrimet doganore, rast pas rasti në varësi të konfirmimit të Drejtorisë së Protokollit pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme, të parashikuar në pikën II/1/a të këtij udhëzimi, sipas formularit në aneksin 2 bashkëngjitur.

**II. Specifikat e furnizimit dhe të përfashtimit**

1. Përfashtimi në import ose nga magazinat fiskale të prodhimit apo stokimit:

a) Në rastet kur furnizimi i subjektit përfitues me lëndë djegëse të përfashtuar nga detyrimet e importit bëhet me autobot nga magazina e lirë, bazuar në autorizimin e përfashtimit, procedohet sipas procedurës standarde të importit (imp. 4) me detyrime importi të përfashtuara. Ngarkesa, përveç deklaratës doganore shoqërohet edhe nga fatura tatimore e shitjes me TVSH zero, sipas legjislacionit në fuqi.

b) Në rastet kur furnizimi i subjektit përfitues me lëndë djegëse të përfashtuar nga detyrimet bëhet me autobot nga magazina fiskale, depozituesi i miratuar, bazuar në autorizimin e përfashtimit, harton dokumentin shoqërues të akcizës (DSHA-në) me detyrime akcize të llogaritura dhe të përfashtuara. Ngarkesa, përveç dokumentit shoqërues të akcizës (DSHA-së) shoqërohet edhe nga fatura tatimore e shitjes, me TVSH zero, sipas legjislacionit në fuqi.

## 2. Përfshirja në pikat e tregimit me pakicë të karburanteve

Në rastet kur subjekti përfitues furnizohet në tregun e brendshëm nga pikat e tregimit me pakicë të karburantit, paraqet periodikisht, një herë në muaj, një kopje të autorizimit, faturës tatimore dhe të kuponëve tatimore pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme për të rimbursuar TVSH-në dhe akcizën e paguar. Bazuar në autorizimin sipas aneksit nr. 2, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave transferon periodikisht në Ministrinë e Punëve të Jashtme, vlerat e akcizës për t'u rimbursuar. Ministria e Punëve të Jashtme, një herë në muaj, rimbursin akcizën e paguar nga përfituesi dhe të transferuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, si dhe Tatimin mbi Vlerën e Shtuar bazuar në skemën ligjore të rimbursimit të këtij tatimi për trupin diplomatik.

## III. Dispozita të fundit

1. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

2. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCËVE

**Arben Ahmetaj**

**Aneksi 1**

**APLIKIM PËR PËRJASHTIM  
PËR LËNDËT DJEGËSE PËR MISIONET DIPLOMATIKE DHE KONSULLORE, MISIONET SPECIALE TË  
AKREDITUARA NË SHQIPËRI SI DHE TË ORGANIZMAVE NDËRKOMBËTARE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot. \_\_\_\_\_

Tiranë, më / /

Subjekti përfitues aplikues : \_\_\_\_\_

Adresa: \_\_\_\_\_

NIPT (nëse disponon)

Dokumentat shoqëruese të aplikimit : \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Shitësi/furnizuesi

1. Lloji i lëndës djegëse që kërkohet të përjashtohet ne import/ magazine fiskale me autobot
2. Lloji i lëndës djegëse që kërkohet të përjashtohet/rimbursohet ne blerje brenda vendit me pakice

1. Sasi e lëndës djegëse që kërkohet të përjashtohet ne import/ magazine fiskale me autobot
2. Sasia e lëndës djegëse që kërkohet të përjashtohet/rimbursohet ne blerje brenda vendit me pakice

2

Baza ligjore e përjashtimit dhe taksat nga te cilat përjashtohet

Destinacioni i lëndës djegëse.

**Nënshkrimi i subjektit kërkues**

|                                                                                                                                                                                                                 |                                                        |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------|
| <br><b>REPUBLIKA E SHQIPËRISË</b><br><b>MINISTRIA E FINANCAVE</b><br>Drejtoria e Përgjithshme e Doganave<br>Departamenti _____ |                                                        |
| Nr. _____ Prot.                                                                                                                                                                                                 | Tiranë, më ____ / ____ / 2016                          |
| <b>AUTORIZIM NR.</b><br><b>PËR PËRJASHTIM TE LËNDËVE DJEGËSE PËR MISIONET DIPLOMATIKE DHE KONSULLORE,</b><br><b>MISIONET SPECIALE TË AKREDITUARA NË SHQIPËRI SI DHE TË ORGANIZMAVE NDËRKOMBËTARË</b>            |                                                        |
| Subjekti përfitues:<br>_____                                                                                                                                                                                    |                                                        |
| Adresa: _____                                                                                                                                                                                                   |                                                        |
| Baza ligjore përjashtimit :                                                                                                                                                                                     |                                                        |
|                                                                                                                                                                                                                 |                                                        |
|                                                                                                                                                                                                                 |                                                        |
| Sasia dhe lloji i karburantit me autobot nga<br>Importi/Magazinat Fiskale dhe taksat qe<br>perjashtohen ne import/Magazina Fiskale<br>(TVSH, AKCIZE, TAKSE QARKULLIMI,<br>TAKSE KARBONI)                        |                                                        |
| Sasia dhe lloji i karburantit me pakice dhe taksat<br>qe rimbursohen<br>(TVSH AKCIZE) per blerje brenda vendi                                                                                                   |                                                        |
| Dokumenta shoqëruese:<br>_____<br>_____<br>_____                                                                                                                                                                |                                                        |
| Shitësi/furnizuesi<br>Shënime                                                                                                                                                                                   |                                                        |
|                                                                                                                                                                                                                 | _____<br>(emer mbiemer nënshkrimi)<br><b>Titullari</b> |